



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. 2276/Prot.  
13

Pogradec, më 30 . 05 .2024

VENDIM

NR. 64 , DATË 29 . 05 .2024

**“PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”.**

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL“ përkatësisht: Nenit 2, pika: 13,14,15,20,25,27,44,49, 51; Neni 3, pika 3 ; Neni 40,41,42,43 “Subvencionim i Interesave Të Kredisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Miratimin për sistemin e pikezimit mbi projektin “Subvencionim i Interesave Të Kredisë”.

| SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT<br>“SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË” |  |           |
|--|--|-----------|
| NR.  | KRITERET E PIKËZIMIT   | PIKËT     |
| <b>A</b>   | <b>KUSHTET E STREHIMIT</b>   | <b>25</b> |
| i  | Nuk disponojnë banesë në pronësi   | 6         |
| ii   | Kanë ngelur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.   | 5         |
| iii  | Banesa në rrezik shembje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastrehë.  | 5         |
| iv   | Banojnë në banesa të mbipopulluara sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.   | 4         |
| v  | Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike.                                   | 5         |
| <b>B</b>   | <b>KUSHTET FAMILJARE</b>   | <b>25</b> |
| i  | Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë,ku përfshihen edhe vajzat nëna.   | 5         |
| ii   | Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore. | 0         |
| iii  | Familjet me më shumë se 4 (katër) fëmijë.  |           |



|          |   |            |
|----------|---|------------|
| iv       | Familjet e reja, ku moshë e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.                             | 8          |
| v        | Të rinj, që në momentin e aplikimit kanë moshë jo më të madhe se 40 vjeç.   | 7          |
| <b>C</b> | <b>KUSHTET SOCIALE</b>  | <b>25</b>  |
| i        | Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori dhe me shërbime kujdestarie. | 4          |
| ii       | Individë më statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç.                                    | 2          |
| iii      | Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve.  | 0          |
| iv       | Emigrantë të rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese.   | 2          |
| v        | Familjet e policëve të rënë në detyrë.  | 0          |
| vi,      | Punonjës i reparteve të ndërhyrjes së shpejtë FNSH  | 3          |
| vii,     | Punonjësit e repartit RENE A  |            |
| viii     | Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit  |            |
| ix       | Viktimat e trafikimit / Viktimat e mundshme të trafikimit   | 3          |
| x        | Anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian  | 4          |
| xi       | Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit.                           | 2          |
| xii      | Vajzat Nëna.  | 3          |
| xiii     | Individët që i përkasin komuniteti LGBTI, të cilët janë viktime për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor                                  | 2          |
| <b>D</b> | <b>KUSHTET EKONOMIKE</b>  | <b>25</b>  |
| i        | Të ardhurat nën 70% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.   | 7          |
| ii       | Të ardhura 70-100% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.  | 9          |
| iii      | Të ardhura 100-120% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.   | 9          |
|          | <b>TOTALI PIKË</b>  | <b>100</b> |

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI




1. Miratuar me 22 vota

2. Vota Pro 22

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më datë 30.05.2024